



VENDIM

Nr. 50 Datë 7.06.2011

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË "KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (HEC I KALIVACIT), SI
BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 18.03.2009, neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.06.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Kalivac Green Energy" sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues të HEC "Kalivaçi", si burim i rinovueshëm energjie, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Kalivac Green Energy" sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat "a", "b", "c", "d"**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 2, gërma "a", "b", "c", "d"**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 4, gërma "a", "b", "c"**
Është plotësuar tërësisht

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të "Kalivac Green Energy" sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s
NE DETYRE
Entela SHEHAJ**